



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:292061
Datë: 16.04.2024
Numri i dokumentit: 05580168

Ac.nr.8944/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Fatmir Baloku dhe Burim Shala-anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Kompania e Sigurimeve ‘‘Elsig’’ Sh.a, Rruga Tring Smajli nr.3 Prishtinë, kundër të paditurit B..... (I.....) G....., fshati Sapniq, komuna e Rahovecit, lidhur me rimbursimin e dëmit, vlera e kontestit 2,000.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së paditësit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec C.nr.435/2019 të datës 19.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit Kompania e Sigurimeve ‘‘Elsig’’ Sh.a, PRISHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec C.nr.435/2019 të datës 19.10.2022 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e atakuar C.nr.435/2019, të datës 19.10.2022, ka venosur në këtë mënyrë: Padia e paditëses Kompania e Sigurimeve KS ‘‘ELSIG’’, - Prishtinë, e ushtruar pranë kësaj gjykate, kundër të paditurit Blendi Ilir Gashi, për shkak të zhdëmtimit në bazë të regresit, KONSIDEROHET E TËRHEQUR. Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësja, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, ertetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim si në të njëjtën.

Nuk është parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me datë 11.11.2019, ka ushtruar padi kundër të paditurit Blendi Ilir Gashi për shkak të zhdëmtimit-regresit. Gjykata, me aktvendimin e datës 24.12.2021, e ka obliguar paditësen që afat prej 8 ditëve ta rregullojë padinë në atë mënyrë që do ta sigurojë adresën e saktë për të paditurin. Paditësja edhe pse e ka pranuar Aktvendimin me datën 21.12.2018, ndërsa parashtresën e ka paraqitur duke mos iu përmbajtur aktvendimit të gjykatës me pretendim se është e vetmja adresë të cilën e posedon paditësja duke i propozuar gjykatës që me qëllim të sigurimit të adresës së saktë të të paditurit ti drejtohet Policisë së Kosovës dhe Qendrës për Regjistrim Civil. Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 102.3 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konsideruar se padia e paditëses është tërhequr.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e kësaj çështje, vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 pika i) të LPK, pasi që paditësit nuk i është dhënë mundësia e shqyrtimit të rastit të tij në mënyrë meritore, përkatësisht çështja e tij nuk është zgjidhur në themel, se është e bazuar apo jo kërkesëpadija e tij. Po ashtu sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit edhe gjendja faktike në këtë procedurë nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për të cilën arsye pastaj ka ardhur edhe deri te zbatimi i gabuar i dispozitave procedurale, përkatësisht nenit 102 të LPK-ës.

Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit, se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gabimsisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike dhe si rrjedhojë aktvendimi është i përfshirë në zbatim të gabuar të së drejtës material, për faktin se sipas nenit 79 paragrafi 3 të LPK-së parashihet se *“Gjykata do t’i caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në këto raste : a) në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me procure.* Nisur nga kjo dispozitë ligjore, Gjykata e Apelit vlerëson se, çështjet që kanë të bëjnë me adresën nuk mund ti atribuohen mos plotësimi e padisë nga neni 99 dhe 102 i LPK-së. Gjykata e shkallës së parë do të duhej ti shoh mundësitë e gjetjes së adresës përmes evidencës së regjistrimit civil dhe krejt në fund në qoftë se edhe kjo përpjekje ka rezultuar e pa suksesshme, atëherë të paditurit do të duhej ti caktohet përfqësuesi i përkohshëm konform nenit 79 paragrafi 3 të LPK-së dhe ta detyron paditësin për deponimin e mjeteve financiare për pagesën e përfaqësuesit të përkohshëm, e në rast paditësi këtë deponim nuk e bënë, atëherë plotësohen kushtet ligjore për hedhje poshtë të padisë së paditësit, për mungesë të prezumimeve procedurale sa i përket palëve ndërgjyqëse, në rastin konkret në lidhje me të paditurin.

Udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të veprjës sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, t'i eliminojë shkeljet e sipër theksuara, ti caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm, të vlerësoj të gjitha prezumimet procedurale që kanë të bëjnë me gjykatën, palët-përfaqësimin, objektin e kontestit dhe rregullsitë formale të padisë dhe të vendos për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit dhe pasi të konstatoj se janë plotësuar të gjitha kushtet procedurale për vendosje në këtë procedurë, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për vërtetimin sa më të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë procedurë dhe më pastaj të aplikoj drejtë të drejtën materiale.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195 dhe neneve 208 dhe 209 par. 1 pika (d), të LPK, në lidhje me nenin 3 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8944/2022, datë 16.04.2024

Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi